



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0823

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim – Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi- Brajshori - Anëtar të panelit, duke vendosur sipas ankesës së OE “Phantom Solutions” Sh.P.K. kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush” me numër të prokurimit 616-24-8261-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës, me datë: 15.11.2024 mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Phantom Solutions SH.P.K. me nr. 2024/0823, e datës 31.08.2024, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit 100 Ndërtim i sheshit Xhorxh Bush me numër të prokurimit: 616-24-8261-5-1-1
2. Vërtetohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartëshënuar sipas pikës I të dispozitivit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Phantom Solutions SH.P.K.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me datë 14.08.2024 Komuna e Prishtinës cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush” me numër të prokurimit 616-24-8261-5-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar 18.400,000.00€.

Me datë 31.08.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë dhe kërkesave në Dosjen e Tenderit, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 04.09.2024.

Me datë 09.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0823.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi nr. 1-*sipas OE ankues publikimii këtij aktiviteti te prokurimit është bere me datën: 14/08/2024, dhe se sipas dosjes se tenderit afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është data 06/09/2024. Me rastin e përcaktimit te afatit te fundit për dorëzimin e tenderëve, AK ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 44 dhe Nenin 45 te LPP.*

Pretendimi nr. 2 – *sipas OE ankues për menaxherin e projektit është kërkuar qe te ketë certifikate për mbrojtjen nga zjarri nder te tjera. E ndërsa inxhinieri i radhës i ndërtimitarisë, drejtimi hidroteknike është kërkuar qe te ketë certifikate për testim te tubacioneve EN805W400, kërkesë kjo qe nuk ka te beje me projektin, por aplikohet ne projektet e shtrirjes se ujës jellesit dhe tubave me presion. Për një inxhinier të tjetër është kërkuar qe te jetë i certifikuar sipas ISO 9001 dhe se sipas OE ankues ky certifikim është certifikate qe i lëshohet kompanive për sisteme cilësorë te menaxhimit, por nuk ka te beje me individët. Pyetja qe shtrohet për Autoritetin Kontraktues është perse pikërisht pre këtë inxhinier është kërkuar kjo certifikate, ejo për ndonjë nga inxhinieret e tjerë, kur kjo certifikate nuk ka te beje asgjë me kualifikimin e inxhinierëve apo aftësinë e tyre inxhinierisë/teknike.*

Pretendimi nr. 3 – *OE ankues pretendon se AK-ja ka vendosur kritere diskriminuese ne rastin kur ka kërkuar nedosje te tenderit kërkesën, si certifikate ISO 50001, ISO 3834-2. ISO 50001, qe sipas OE ankues është certifikim për menaxhimin e energjisë, qe nuk ka asnjë lidhshmëri te mundshme me projektin ne fjale. Gjithashtu ISO 3834-2 është certifikim për saldimin e metaleve, qe nuk ka asnjë lidhshmëri me projektin ne fjale.*

Pretendimi nr. 4 – *sipas OE ankues, se AK-ja, ka kërkuar te dorëzohen mostra, por nuk ka përcaktuar se kur duhet dorëzuar te njëjtat.*

Pretendimi nr. 5 - *OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kërkesa diskriminuese edhe ne kërkesën për makineri, duke vendosur kërkesë për eskavator me krah te gjate minimum 22metër, dhe duke mos dhënë asnjë sqarim as ne informatat sqaruese se pse*

është e nevojshme kërkesë. Eskavatoret e tillë përdoren për pastrimin e lagunave apo të ngashme kur duhet gërmuar në thellësi mbi 22 metra, ndërsa në projektin në fjalë një gërmim i tillë nuk është parapare askund.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0823 ndërsa me datë 03.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimin nr. 1 – *“Eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim i OE ankues qëndron mirëpo te njëjtin pretendim OE ankues e ka parashtruar edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe këtë pretendim* *AK-ja* *e*
ka aprovuar site bazuar dhe njëherit ka dërmarr veprimet duke e publikuar njoftimin për korrigjimin e gabimeve, konkretisht duke e shtyrë afatin për dorëzimin e ofertave”.

Lidhur me pretendimin nr. 2- *“Eksperti teknik vlerëson se sa i përket testimit të tubacioneve të cilët vendosen sipas projektit, në fund gypat testohen prej laboratorit përkatës të licencuar i cili merr përgjegjësinë përcilësinë dhe presionin e gypave sipas projektit. Testimi nuk bëhet në mënyrë individuale. Pretendimi i OE është i bazuar. Sipas mendimit të ekspertit teknik duhet të bëhet edhe njëherë korrigjimi-përmirësimi i kriterit të kërkuar në dosje të tenderit”.*

Lidhur me pretendimin nr. 3 - *“Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar paramasën dhe parallogarin e publikuar në E-Prokurim, sqaron se në secilin kapitull ka punë të instalimeve energjetike dhe të ndriçimit. Prandaj, nuk qëndron ky pretendim i OE ankues”.*

Lidhur me pretendimin nr. 4 – *“eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues sepse AK-ja edhe në vendimin e kërkesës për rishqyrtim e ka sqaruar këtë pretendim”.*

Lidhur me pretendimin nr. 5 – *“eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, duhet të jap sqarime me të detajuara sepse në paramasën e publikuar, punët të cilat do të realizohen nuk është e qarte se aashte nevojshme kjo pajisje me këtospecifika”.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë inicimit të aktivitetit të prokurimit, hartimit dhe publikimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur që elaborimet e ekspertit shqyrtues/teknik lidhur me pretendimin nr. 1, 3 dhe 4 janë mjaft të detajuara, konkrete dhe të sakta për shkak se janë të bazuara në LPP në fuqi por edhe në faktet dhe dëshmitë që janë pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Prandaj Paneli Shqyrtues pajtohet në tërësi me mendimet e ekspertit sa i përket pretendimit nr. 1, 3 dhe 4 dhe konsideron se këto pretendime si të tilla janë të pabazuara në tërësi.

Lidhur me pretendimin nr. 2, Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin elaborimit të ekspertit ku thuhet se *“ne fund gypat testohen prej laboratorit përkatës të licencuar”*, pasi që një kërkesë e tillë nuk është pjesë e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë, paramasës apo projektit ekzekutiv. Në anën tjetër sipas pretendimit ankimor për parashtruesin e ankesës kjo kërkesë është e panevojshme dhe duhet të largohet në tërësi pra nuk është kontestues nëse testimi do të bëhet nga laborator apo në vendpunishte. Sipas sqarimeve shtesë që ka ofruar lidhur me kërkesën përkatëse e cila në kuptim e vlefshmërisë është e barazvlefshme me fuqinë e cilësdo kërkesë të dosjes së tenderit, testimi i gypave duhet të bëhet në vendpunishte që nënkupton duhet të bëhet paralelisht me procesin e punës gjatë realizimit të projektit. Nga ky këndvështrim Paneli Shqyrtues i ka falur besimin sqarimeve të ofruara nga AK duke perdorur formularin për korigjimin e procedurës NJT-se -DT-se , dhe ka gjetur se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 5, Paneli Shqyrtues konsideron se eksperti shqyrtues nuk e ka vlerësuar pretendimin nëse është i bazuar apo i pabazuar por vetëm ka konstatuar se *“AK-ja, duhet te jap sqarime me te detajuara sepse ne paramasen e publikuar, punët te cilat do te realizohen nuk është e qarte se aashte nevojshme kjo pajisje me ketospecifika”*. Ngjashëm edhe pretendimi ankimor më shumë manifestohet për shkak të mungesës së sqarimeve nga AK sesa që shprehimisht kërkohet të largohet kjo kërkesë. Nga ky këndvështrim Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka ofruar 3 herë sqarime në 3 pyetjet sqaruese të operatorëve të ndryshëm

ekonomik lidhur me këtë kërkesë. Konkretisht AK ka argumentuar se kjo pajisje është e domosdoshme për të realizuar punimet në hapësira të mëdha dhe komplekse të përcaktuara përmes disa pozicioneve në paramasë ku punimet duhet të zhvillohen nga së paku 22 metra distancë dhe zhvillimi i punimeve në distancë më të shkurtër nuk është i përshtatshëm. Në këtë formë AK e ka arsyetuar kërkesën e paraqitur përmes dosjes së tenderit dhe ka vepruar në përputhje me nenin 53 lidhur me nenin 58 si dhe nenin 27 të LPP. Në këtë mënyrë është gjetur se ky pretendim ankimor është i pabazuar. Mirëpo përtej këtyre fakteve, vlen të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë dhe kompetencën ligjore për të inicuar dhe publikuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit sipas kërkesave të hartuar në përputhje me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi për prokurimin.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqjen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit publik. Sipas sqarimeve shtesë të autoritetit kontraktues

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet pabazuar ndërsa Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit e publikuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *“100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush”* me numër të prokurimit 616-24-8261-5-1-1 mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që ndryshoj kërkesat e dosjes së tenderit, për arsyt e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - PHANTOM SOLUTIONS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: